



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019 ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja- kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 5 dhe 7 nëntor 2019
2. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Fatmir Xhafaj, Alban Zeneli, Aurora Mara, Ediola Braha, Elda Hoti, Elena Xhina, Adriatik Alimadhi, Andi Përmeti, Nikolin Staka dhe Artemisa Malo.

Mungojnë:

Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Edmond Leka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Anila Denaj- Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë;

Nikolla Lera- Drejtor i Përgjithshëm, i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale

Mimoza Dhëmbi- Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave;

Endrit Lami- Drejtor i Politikave Makroekonomike

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Të hyjë media!

Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me rendin e ditës.

Në fakt, është një seancë e rëndësishme, sepse akti juridik më i rëndësishëm për një parlament është buxheti. E lamë sot për në orën 12:00 seancën e komisionit, për shkak se në shqyrtimin dhe miratimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” duhet të kishim prezent në komision për të prezantuar projektbuxhetin ministren e Financave, zonjën Anila Denaj. Kjo është arsyeja pse mbledhja u thirr në këtë orë.

Unë po ju prezantoj rendin e ditës, së pari, kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të datave 5 dhe 7 nëntor të vitit 2019. A jeni dakord me procesverbalet?

Dakord.

Pika e dytë është shqyrtimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e shtetit 2020”. Komisioni ynë është për dhënie mendimi. Relator është zoti Fino. Kemi prezent ministren , zonjën Denaj, e cila shoqërohet nga zoti Nikolla Lera, drejtor i përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Fiskale, zonja Mimoza Dhëmbi, drejtore e përgjithshme e Buxhetit dhe zoti Fran Brahimi, ekspert.

Rëndësia e kësaj seance sot ka të bëjë me faktin që në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve janë 22 institucione kushtetuese dhe të krijuara me ligj që zënë një pjesë të konsiderueshëm të buxhetit të shtetit, aq më tepër që Komisioni i Ligjeve, si komisioni më i rëndësishëm i Kuvendit, është komisioni që ndjek drejtpërsëdrejti edhe ecurinë e zbatimit të reformës në drejtësi, po të kemi parasysh se ç’pjesë zë në zërin buxhetor suporti që kjo qeveri i jep reformës në drejtësi.

Fjalën e ka zonja Denaj për të bërë një prezantim të përmbledhur të buxhetit të vitit 2020, më pas do të flasë relatori, zoti Fino, pastaj do të ketë pyetje dhe diskutime nga kolegët dhe në fund miratimi në parim.

Anila Denaj – Faleminderit!

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti i viti 2020, i prezantuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është një projektbuxhet, i cili mbetet i angazhuar drejt një kuadri makroekonomik, i kujdesshëm dhe realist për një konsolidim fiskal të vazhduar, financa publike të forta, stabilitet financiar dhe qëndrueshmëri të pozicionit të jashtëm të Shqipërisë.

Në terma të politikave dhe indikatorëve makroekonomikë, ky buxhet synon realizimin e një rritjeje ekonomike, e cila parashikohet të jetë në nivelin 4,1% në vitin 2020, një rritje e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Kjo rritje e parashikuar për vitin 2020 do të përkthehet në më shumë punësim, konkretisht krijimin e rreth 35 mijë vendeve të reja pune dhe uljen e mëtejshme të shkallës së papunësisë poshtë nivelit 11%”.

Projektbuxheti i vitit 2020 siguron një nivel të lartë të investimeve publike, mbi 4,5% të produktit të brendshëm bruto, në mbështetje të rritjes ekonomike dhe punësimit.

Gjithashtu, synohet ruajta e balancës primare pozitive, e cila do të jetë pozitive për të pestin vit radhazi në nivelin 0.7%, duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse, ndërsa në fund të vitit 2020 borxhi publik pritet të ulët në nivelin e 62,2% të PBB-së, për të zbritur poshtë 59% të PBB-së në 2021 dhe më tej në rreth 57% në vitin 2022.

Përmes projektbuxhetit synohet mbajtja e deficitit buxhetor nën nivelin e 2%, ku për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1,6% të produktit të brendshëm bruto, niveli më i ulët i targetuar në dy dekadat e fundit.

Shpenzimet buxhetore të programuara për vitin 2020 janë rreth 532 miliardë lekë ose rreth 29,7% të produktit të brendshëm bruto, me një rritje rreth 5,1% krahasuar me të pritshmin e vitit 2019.

Më specifikisht, në vitin 2020, parashikohet që konsumi total të rritet në terma realë me rreth 2,5% duke dhënë një kontribut prej 2,3 pikë përqindje në rritjen e PBB-së, investimet totale do të rriten me 4,3% ose me kontribut me rreth 1 pikë përqindje, ndërsa kërkesa e huaj neto

(eksporte – importe) parashikohet të përmirësohet me rreth 5% ose me një kontribut pozitiv prej 0,8 pikë përqindje në PBB.

Në anën e ofertës agregate, kontributi pozitiv u atribuohet të gjithë sektorëve, ku kryeson ai i shërbimeve, veçanërisht tregtia, hoteleria dhe transporti në reflektim edhe të performancës së turizmit, ndjekur nga sektori i bujqësisë dhe ai i industrisë.

Tregu i punës ka shfaqur një ulje të mëtjshme të shkallës së papunësisë nën nivelin prej 12% në tremujorin e dytë, niveli më i ulët i regjistruar gjatë dy dekadave e fundit.

Punësimi u rrit me 3,3%, ushqyer kjo kryesisht nga rritja e shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës. Rritja e punësimit është kyçe për gjenerimin e të ardhurave të disponueshme të familjeve, e për rrjedhojë për të nxitur konsumin, kursimet e investimet dhe rritjen e mëtjshme të ekonomisë.

Indeksi tremujor i ndjeshmërisë ekonomike ka ndjekur përgjithësisht një trend pozitiv gjatë tre tremujorëve të këtij viti kundrejt fundvitit të kaluar dhe qëndron konsiderueshëm mbi mesataren afatgjatë të tij.

Kreditë me probleme kanë vijuar të ulen tashmë deri në nivelin rreth 11%, nga 24% vite më parë. Gjithashtu, kreditimi i sektorit privat të ekonomisë ka regjistruar një rritje prej mbi 7% kundrejt një viti më parë, e cila i atribuohet si kredisë drejt bizneseve, ashtu edhe asaj drejt konsumatorëve.

Më tej, në vitin 2019 ka pasur një zgjerim të deficitit të llogarisë korente për gjysmën e parë të këtij viti, duke reflektuar kryesisht importe më të larta të mallrave me + 3% dhe një tkurrje të eksporteve me -2.8% në 9-mujorin e vitit 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.

Në të njëjtën kohë, flukset e larta të IHD-ve, me një rritje prej mbi 10% kundrejt një viti më parë, kanë sjellë një zgjerim të suficitit të llogarisë financiare dhe kapitale.

Konsolidimi fiskal është materializuar në një trajektore pozitive për borxhin publik dhe deficitin buxhetor me pritshmëri nën 2% nga 5% të PBB-së në vitin 2013.

Në këtë kuadër makrofiskal nuk mund të mos përmend mungesën e të ardhurave për vitin 2019, e cila vjen me një reduktim me 1,8% krahasuar me planin e periudhës. Sidoqoftë një mungesë e tillë është totalisht e amortizuar nga të gjitha hapësirat e krijuara në buxhetin fillestar.

Parashikimi i të ardhurave për buxhetin e vitit 2020 është bazuar në vlerësimin rigoroz të rezultatit të pritshëm për vitin 2019. Në parashikimin e të ardhurave janë faktorizuar në mënyrë të ndërlidhur edhe variablat makroekonomikë me faktorët kryesorë që ndikojnë në taksa specifike, të cilët janë: rritja nominale e produktit të brendshëm bruto, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike, si dhe me projeksionet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare me impakt tek taksat advalorem, si tatimi mbi vlerën e shtuar; renta minerare dhe taksa doganore; kursi i pritshëm i këmbimit; sasi të pritshme të importit të mallrave në përgjithësi dhe atyre me regjim akcize në veçanti; si dhe programimi i fondeve të nevojshme për rimbursimin e tatimpaguesve, me qëllim uljen e stokut në fund të vitit 2020 me rreth 67 % krahasuar me stokun e pritshëm në fundin e vitit 2019.

Të ardhurat totale të buxhetit të shtetit në fund të vitit 2019 pritet të jenë rreth 474 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2018, rritja rezulton +5,3% ose 24 miliardë lekë më shumë. Totali i të ardhurave të pritshme në raport me PBB-në në fund të këtij viti rezulton 27,8%, nga 27,6 % që ishte në vitin 2018.

Të ardhurat totale për vitin 2020 parashikohen me një rritje prej 6,2% mbi të ardhurat e pritshme të vitit 2019 ose rreth 29,2 miliard lekë më shumë.

Shpenzimet buxhetore të programuara për vitin 2020 janë rreth 532 miliardë lekë ose rreth 29,7% e produktit të brendshëm bruto. Ato rriten me rreth 5,1% krahasuar me vitin 2019.

Sektorët prioritarë. Arsimit i alokohen 3.3 miliardë lekë më shumë se buxheti i vitit 2019, duke financuar me përparësi: tekste shkolllore falas për rreth 230-250 mijë nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë, me një efekt prej rreth 500 milionë lekë në vit; trajtim me kuotë ushqimore për 1300-1400 nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë; investim në arsim mesatarisht 750 milionë lekë në vit gjatë 2020 – 2022, 2 herë më tepër nga 340,5 milionë në vit që kanë qenë më parë; mbështetje e vazhdueshme për studentët në kuadër të Paktit për Universitetin.

Sektori i dytë, po aq i rëndësishëm dhe me një mbështetje më të lartë buxhetore, është sektori i shëndetësisë, i cili do të ketë 2,75 miliardë lekë më tepër se viti 2019. Ky buxhet do të mbështesë: rikonstrukcionin e 120 qendrave shëndetësore për vitin 2020 me një vlerë prej 350 milionë lekësh; ilaçe të rimbursuar për 1000 pacientë më shumë çdo vit gjatë 2020-2022; do të rrisë efektivitetin në shërbimet shëndetësore, si, për shembull, reduktimin e kohës aktuale prej 45 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë, skaner) etj.

Sektori i tretë prioritar dhe i rëndësishëm është bujqësia, të cilit i alokohen 1,8 miliardë lekë më shumë se viti 2019 ose rreth 12% më tepër. Sektori i bujqësisë pritet të rrisë produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e produkteve bujqësore dhe blegtorale gjatë periudhës 2020-2022, duke përmirësuar standardet, duke garantuar sigurinë ushqimore dhe zhvillimin e zonave rurale përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në këto zona.

Shpenzimet kapitale ose investimet publike do të pësojnë një rritje 4.7% në raport me PBB-së dhe rreth 4% krahasuar me të pritshmin e këtij viti. Në planifikimin e investimeve për vitin 2020 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu si në vitin 2019, edhe në vitin 2020 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim, duke synuar mbylljen e tyre brenda vitit 2021. Në infrastrukturën rrugore, për periudhën 2020-2022, synohet kompletimi i akseve rrugore nacionale dhe segmenteve rrugore: kompletimi i akseve rrugore nacionale, si: Rruga e Arbrit, Milot – Balldren dhe Orikum – Dukat brenda vitit 2022; kompletimi i pjesës dërmuese të segmenteve rrugore në vazhdim me financim të brendshëm brenda vitit 2022, si: Kardhiq – Delvinë, Elbasan – Banjë, baipasi Shkodër, baipasi Tepelenë, një pjesë e mirë e Unazës së Tiranës; kompletimi i segmenteve rrugore brenda vitit 2021 me financim të huaj si: baipasi i Fierit, baipasi i Vlorës, Qukës – Qafë Plloçë. Qeveria shqiptare synon në vazhdimësi reduktimin e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 25%.

Në fushën e sigurisë kombëtare kemi rritur buxhetin e mbrojtjes me rreth 2,8 miliardë lekë më shumë, krahasuar me buxhetin e vitit 2019, për të garantuar realizimin e objektivit të qeverisë dhe angazhimet tona në NATO për 2% të PBB në vitin 2024, si buxhet për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky buxhet, gjithashtu, plotëson të gjitha nevojat financiare të të gjitha institucioneve të reja të krijuara nga paketa e reformës në drejtësi si, KLP, KLGJ, Byroja e Hetimit dhe SPAK-u, duke akomoduar plotësisht financimin për reformën në drejtësi dhe duke mundësuar burimet e nevojshme financiare për pagat e rritura të magistratëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Gjithashtu, buxheti alokon një fond të rëndësishëm për shpenzimet e personelit, të programuara në masën 83,5 miliardë lekë për vitin 2020 ku, përveç financimit të plotë të kostos aktuale të administratës publike qendrore, faktorizohen, gjithashtu, edhe efektet e plota të politikës së rritjes së pagave për sektorin e shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes, sistemit penitenciar dhe punonjësit e përfaqësive diplomatike, të cilat u realizuan në muajin prill të këtij viti; shpenzimet

operative dhe mirëmbajtjes, të programuara në vlerën 50 miliardë lekë, duke prioritetizuar: mbështetjen e skemës së fermerëve, mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit në administratën publike dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor kombëtar; shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin 40,9 miliardë lekë ose 2,3% të PBB, të cilat përfshijnë kontigjenca të mjaftueshme për të përballuar edhe nëse do të kishte një rritje të normave të interesit nga 1 deri në 2 pikë përqindje mbi nivelin aktual, edhe pse ne pretendojmë se do të jetë më i ulët se i mëparshmi.

Më lejoni të theksoj se vitin që vjen ne hyjmë në një proces të rëndësishëm për të katërtën herë radhazi për këtë periudhë kohe të viteve të fundit për eurobondin, megjithatë, sikurse është theksuar sot në Komisionin e Ekonomisë mendojmë se tregjet janë në favor që kjo kontigjencë të mos preket.

Sa u përket subvencioneve të programuara, ato janë rreth 1,3 miliardë lekë. Këtu është faktorizuar rialokimi i një pjese të mirë të subvencionit të parashikuar për ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizime tek investimet publike për rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve, në kuadër të përshpejtimit të reformës së ndërmarrë nga qeveria për këtë sektor.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshijnë shpenzimet totale për fondet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej 188,6 miliardë lekësh për vitin 2020.

Niveli i shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2020 parashikohet në masën 137,5 miliardë lekë ose 7,7% e PBB-së, raport thajse i njëjtë me vitin 2019, nga e cila për indeksimin e pensioneve është parashikuar një fond prej 2,52 miliardë lekësh.

Në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020 janë parashikuar në rreth 44 miliardë lekë ose 2,5% e PBB-së nga rreth 42 miliardë lekë të parashikuara në fund të vitit 2019.

Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve: parashikohen në total rreth 4,5 miliardë lekë nga rreth 1,9 miliardë lekë që ky fond ishte në vitin 2013. Që prej vitit 2016 fondi i kompensimit është planifikuar në rritje nga vit në vit duke kulmuar në vitin 2022 me 5,5 miliardë lekë.

Rritja e fondit të kompensimit në vlerë të pronarëve bëhet në mbështetje të reformës së ndërmarrë nga qeveria për trajtimin e ish-pronarëve, pjesë e së cilës është kompensimi në vlerë për t'u realizuar brenda periudhës 10-vjeçare, të parashikuar edhe në ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit”.

Shpenzime të tjera sociale janë programuar në masën 24,6 miliardë lekë, që përfshijnë: shpenzimet për pagesën e papunësisë në nivelin 600 milionë lekë; shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar në nivelin 21 miliardë lekë; për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1 miliard lekësh; për bonusin e lindjeve sërish është parashikuar një fond prej 2 miliardë lekësh. Edhe në këtë vit, nga kjo politikë pritet të përfitojnë rreth 30 mijë familje.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2020 planifikohet në masën 1,7 miliardë lekë, përkatësisht 1,4 miliardë lekë fond rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 300 milionë lekë fond kontigjence për financimin e reformës në sistemin e drejtësisë.

Buxheti i pushtetit vendor për vitin 2020 është programuar në rreth 57 miliard lekë, rreth 11,2 për qind më i lartë se ai i 2019-ës ose rreth 5,7 miliardë lekë më shumë fonde për shërbime dhe investime publike vendore. Kjo rritje prej 3,2% në raport me PBB-në i shërben konsolidimit të procesit të menaxhimit të financiar vendore, zbatimit të reformës administrativo territorial, decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore uljes së stokut të detyrimeve të parapambetura të trashëguara nga ndarja e vjetër territoriale.

Së fundi, më lejoni të ritheksoj se Ministria e Financave dhe Ekonomisë në këtë projektbuxhet është angazhuar të shmangë ose eliminojë risqet që burojnë nga faktorët e jashtëm dhe të brendshëm të ekonomisë, duke shfrytëzuar rolin e saj vendimmarrës në kontekstin e menaxhimit të financave publike, mbikëqyrjes së risqeve që burojnë nga PPP-të apo huamarrjet, ecurinë e ekonomisë botërore, realizimin e të ardhurave apo kursin e pafavorshëm të këmbimit.

Faleminderit.

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre!

Ne jemi Komisioni i Ligjeve dhe si komision i tillë ne do të diskutojmë projektbuxhetin, do ta miratojmë dhe do të kemi seanca dëgjimore me shumë institucione, të cilat për veprimtarinë e tyre janë krijuar me Kushtetutë ose me ligj dhe vijnë e raportojnë këtu në komisionin tonë dhe nuk janë pak, siç tha kryetari i komisionit, por janë rreth 23 institucione, duke filluar nga Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata Kushtetuese, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Kolegji i

Posaçëm i Apelimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisioneri Publik, Presidenti i Republikës (flas gjithmonë për buxhetin), ILDKPKI-ja, KQZ-ja, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Autoriteti për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, duke trajtuar këtu edhe Ministrinë e Drejtësisë, edhe Ministrinë e Brendshme, edhe shoqatat e autonomisë vendore e të tjera me radhë.

I përmenda këto, kolegë deputetë, të gjitha si institucione, sepse në fillim të javës tjetër ne si komision do të kemi një punë të ngjeshur për të bërë takime me të gjithë drejtuesit e këtyre institucioneve kushtetuese dhe ligjore, së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave për të rakorduar përfundimisht dhe për të parë si janë rakorduar fondet për vitin 2020.

Ajo që dua të them, pa dashur të zgjatem shumë, se ju kam bërë një relacion, besoj, shumë shterues dhe tejet interesant, të cilin e keni të gjithë përpara, jua kam bërë gati që dje ju kam orientuar, kolegë deputetë, vetëm drejt problematikës që mbulon komisioni ynë. Natyrisht, kam trajtuar objektivat e buxhetit për vitin 2020, që janë objektivat e përgjithshëm, të cilat ministrja sapo i përmendi dhe e falënderojmë. Por, nga ana tjetër, unë jam për një relacion më të hollësishëm dhe më të zgjeruar për realizimin e reformave, sidomos të reformës në drejtësi, duke i marrë në analizë të gjitha institucionet, sidomos buxhetin vendor, i cili është shumë i rëndësishëm dhe ne kemi detyrë për ta trajtuar.

Kështu, nga pikëpamja e relacionit që kemi përpara (unë nuk do ta lexoj, pasi e quaj kohë të tepërt dhe të humbur për ju, sepse ju e keni mundësinë dhe aftësinë, e keni parë dhe e keni trajtuar), projektbuxheti i vitit 2020 është propozim i Këshillit të Ministrave dhe është në mbështetje të neneve 78, 83 dhe të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pra është brenda shqyrtimit dhe afateve që ne kemi miratuar në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa i përket aspektit ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe, nga ana procedurale, projektligji është i paraqitur dhe po shqyrtohet sipas Rregullores. Ndaj unë ju sugjeroj ta miratojmë atë në parim.

Prandaj nuk u zgjata shumë te relacioni, për t'u dhënë mundësinë edhe kolegëve deputetë për të trajtuar çështje, të cilat kanë të bëjnë me këto dy shtylla kryesore, për të cilat komisioni ynë është komision përgjegjës, por që natyrisht do të kemi diskutime të njëpasnjëshme.

Rezervoj të drejtën, zoti kryetar, të them disa çështje për projektbuxhetin për të marrë një përgjigje më të plotë, jo se nuk e kam gjetur në projektbuxhet, nga ministrja apo nga stafi i saj shoqërues, sepse mund të jenë edhe teknike dhe nuk janë të gjithë të nivelit për të kthyer ministrja përgjigje.

Për t'u lënë kohë ndoshta edhe kolegëve për të bërë pyetje dhe pastaj për të diskutuar në parim dhe politikisht më vonë, pyetja që unë kam dhe që na shqetëson ne (unë e kam gjetur përgjigjen, por, gjithsesi, edhe për opinionin publik), zonja Ministre, dhe ju, zotërinj drejtorë, është: pjesë e rëndësishme e projektbuxhetit të vitit 2020 është edhe mbështetja e reformës së sistemit të drejtësisë (ajo që ne na intereson, por që e kemi trajtuar edhe si komision), a janë akomoduar nevojat buxhetore për të garantuar funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e parashikuara nga ndryshimet kushtetuese dhe të paketës ligjore të reformës në drejtësi? Unë e gjej përgjigjen, ka shifra konkrete atje, por, gjithsesi, një përgjigje politike, si ministre e Financave, do të ishte tejet efektive edhe për kolegët e mi.

Kam edhe një pyetje të dytë përsëri në lidhje me këtë, për t'u lënë mundësi edhe kolegëve të bëjnë më shumë: a janë parashikuar në këtë projektbuxhet, ju e thatë paksa, të gjitha faturat e reformës në drejtësi? Kam parasysh këtu që disa institucione në reformim, mund të mos kenë qenë agresive, mendoj unë, në kërkesat e vitit 2020. Pse? Sepse mosfunksionimi i Gjykatës Kushtetuese, që është një fakt gjatë këtij viti, apo i Gjykatës së Lartë e të tjera, kanë bërë që stoku i çështjeve dhe i dosjeve të jetë rritur duke krijuar probleme për qytetarët. A është adresuar kjo gjë në projektbuxhetin e vitit 2020, pasi këto institucione, për mendimin tim, do të fillojnë veprimtarinë? Ndaj, mundësitë financiare të mos mungojnë, në mënyrë që ato të kryejnë veprimtarinë e tyre. Kjo është edhe përgjigjja që ne duam qoftë si deputetë, qoftë si publik.

Vijmë te disa çështje, tek të cilat, më lejoni të them që mund të jem edhe më ekspert sesa ju për çështjet financiare të pushtetit vendor, pa dashur absolutisht t'ju fyej, por të them që janë edhe gjëra teknike, të cilat ndoshta nuk janë direkt për ju, por janë për stafin që ju shoqëron këtu, madje unë jam i kënaqur që keni një staf shumë të mirë. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar gjatë këtij sesi, por edhe gjatë sesioneve të mëparshme disa ligje, të cilat parashikojnë shtimin e funksioneve në njësitë e qeverisjes vendore. Për shembull, gjatë këtij viti ne kemi miratuar ligjin në fushën e diasporës, në mos gaboj; ligjin në fushën e mbrojtjes civile; projektligjin “Për rininë” para dhjetë ditëve, funksione që shoqërohen me kosto financiare për bashkitë.

Duke marrë në konsideratë parashikimet e Kartës Europiane për Autonominë Vendore dhe kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, që është një ligj organik dhe me shumicë të theksuar, i ndryshuar, unë dua të di: a janë adresuar në projektbuxhetin e vitit 2020 kërkesat për mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore?

Ne e kërkojmë, të jeni e bindur, zonja Ministre, këtu kur vijnë ligje të veçanta, sepse ngandonjëherë u japim funksione organeve të pushtetit vendor dhe nuk i shoqërojmë, siç quhet rëndom, me faturën financiare përkatëse, por u themi: bëje edhe këtë funksion. Por që ta bëjë atë funksion, ai do numrin përkatës, do fondet përkatëse.

Pyetja tjetër që kam: a është parashikuar në këtë projektbuxhet? Këtë e kam të qartë për reformën në drejtësi, e thashë, por dua ta di, sepse në medie është komentuar një udhëzim për vështirësitë financiare të njësive të qeverisjes vendore sikur qeveria po cenon autonominë vendore. Personalisht, që jam edhe kryetari i Nënkomisionit të Pushtetit Lokal, e kam shumë të qartë që as ligji dhe as udhëzimi nuk kanë për qëllim të ngushtojnë autonominë vendore, përkundrazi, ato garantojnë dhe e përforcojnë autonominë vendore.

Por pyetja ime është: çfarë masash keni marrë që të verifikohet situata financiare e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe çfarë do të bëni, pasi t’i verifikoni këto? Çfarë dua të them me këtë, në qoftë se duhet ta shtjelloj disi më tej? Dua të them që ka borxhe të trashëguara nga organet e pushtetit vendor.

Para dy vjetësh ne kemi bërë një reformë të shkëlqyer, do të thosha, shumë të mirë dhe shumë mirë që e kemi bërë reformën territoriale dhe nuk e kemi bërë kot, por sepse nuk mund të drejtohej Shqipëria me 393 njësi vendore, por duhej të drejtohej me 61 të tilla, sikur edhe më pak të ishin, do të ishte edhe më mirë.

Megjithatë, unë mendoj që rishikimi nga ana juaj është që të mbani premtimin për të filluar një proces ristrukturimi të fshirjes së borxhit të punëve publike të kryera nga ndërmarrjet shtetërore, nga FZHR-ja, nga FSHZH-ja, që janë institucione tonat të buxhetit të shtetit, sepse do t’i ndihmonim organet e pushtetit vendor, pra ato 61 bashki, dhe do t’i forconim, ndërkohë të kërkonim edhe më shumë llogari ndaj tyre. Kjo është një pyetje më shumë teknike.

Në vazhdim të kësaj, zonja Ministre, më lejoni t’ju them që ne vazhdojmë ende me tabelën e pagave, sikur jemi ende me 383 njësi vendore. Më vjen keq ta them apo që po jua them juve për herë të parë që vini!

A e dini, zoti kryetar, që sot në pushtetin vendor ka gjashtë kategorizime pagash? Ta dini edhe ju, sepse edhe ju jeni deputet i një zone të caktuar. Nuk duhet të ketë gjashtë kategori. Sot kemi 61 bashki. Sot urgjentisht ministria juaj, Departamenti i Administratës Publike duhet të krijojë dy ose tri kategori të rishikimit të nivelit të pagave. Përse e them këtë gjë? Këtë gjë e ka ngritur edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës në një mbledhje me të gjithë kryetarët e bashkive të Shqipërisë. Sot nuk kemi më 383 kryetarë komunash dhe bashkish, por vetëm 61. Hiqini dy-tri bashki që janë shumë të vogla, pjesa tjetër është me sipërfaqe të madhe, me popullsi të madhe dhe me buxhet vërtet të madh. Pra, duhet të rishikohet puna e kategorizimit të këtyre pagave, sepse është në të mirë të punës dhe të funksionimit të tyre.

Për mua, dhe këtu dua edhe ndihmën tuaj, sidomos të drejtorive tuaja dhe të agjencive që janë pranë Ministrisë së Brendshme, dy janë kategoritë se si rriten të ardhurat e pushtetit vendor: njëra është rritja e të ardhurave nga taksa mbi pronën, që është një burim i pashfrytëzuar deri tani. Me përqindjen që ju keni trajtuar në buxhet, jeni kërkuese dhe kritikuese, bëni shumë mirë që organet e pushtetit lokal duhet ta rrisin, sepse, sa më shumë ta rrisin taksën mbi pronën, aq më shumë të ardhura do të kenë. Kategoria tjetër është ngritja e kadastrës fiskale dhe zbatimi i ligjit të financave lokale që ne e kemi miratuar.

Në qoftë se e kemi miratuar atë, do të thotë se ne jemi shumë në rregull.

Pyetja e fundit që kam, në sensin e buxhetit të pushtetit vendor, zonja Ministre, ju me të drejtë në relacion na thoni se 1% të GDP-së keni llogaritur t'ua jepni fondin e grantit të pakushtëzuar organeve të pushtetit vendor. Ne ju falënderojmë jo pse na e keni dhënë 1%-shin e GDP-së, sepse na e thotë ligji i financave vendore, të cilin e kemi miratuar... Pra, ashtu siç sapa thatë për Ministrinë e Mbrojtjes se e keni 2% të GDP-së në raport me NATO-n, edhe pushteti lokal, që ta dinë kolegët e mi deputetë, e ka 1%, sepse e ka ligji.

Problemi juaj dhe i yni, i maxhorancës, është: sa kemi ne mundësi ta rrisim këtë përqindje, për t'u afruar në përqindjen e GDP-së që kanë vendet e rajonit?

Sot vendet e rajonit, më lejoni t'ju them, e kanë 3% deri në 4% të GDP-së së tyre, që ua japin organeve të pushtetit vendor grantet e pakushtëzuara. A do të shkojmë ne drejt tyre?

Natyrisht, edhe me ato dy elemente që i përmenda pak më parë, pra kadastra fiskale, taksa e pronës ose edhe të ardhura të tjera, do të bëjnë të mundur që pushtetet vendore nesër të mos kërkojnë më investime në linjën zyrtare ose në linjën e ministrive përkatëse, sepse do të kenë këto dy të ardhura, që e thashë, të forta; do ta kenë GDP-në 2% ose 3% nga transfertat e pakushtëzuara

dhe fondet do të jenë kaq të mëdha, saqë ata do të kenë mundësi t'i menaxhojnë vetë. Kështu, do të kemi mundësi ne për të bërë investime kapitale të tjera që na i kërkon shteti dhe i kërkojmë edhe ne vetë.

Çështjen e fundit që kam, ndoshta bëhem i bezdisshëm, por do t'jua them edhe juve, si Ministre, sepse gjatë kësaj kohe që keni në detyrë jeni ingranuar për të dhe jam shumë i bindur se jeni ingranuar. E kam kërkuar edhe për projektbuxhetin e vitit të kaluar, po e them përsëri për të qenë i ndërgjegjshëm me veten time dhe të jem i qetë, pasi mund të mos zgjidhet gjë, por shpresoj që këtë vit me ju të zgjidhet, zonja Ministre, na keni paraqitur këtu nenin 12 të projektligjit, të cilin do ta votojmë ne nen për nen, jo sot, sepse sot do ta votojmë në parim, ku thuhet: “Paga e Presidentit të Republikës është 257 mijë lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit sipas përcaktimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Pse e kaloni ju këtë?! T'ua them kolegëve, se ju e dini, jeni ministre e Financave, por edhe unë e di, sepse jam ekonomist. Kjo, zotërinj kolegë, kalohet, për të treguar që është paga më e lartë në administratën tonë shtetërore. Kjo do të thotë që poshtë kësaj page janë të gjitha pagat e tjera, gjë që ka lidhje me formularin 1, në mos gabo, të numrit të punonjësve, që është 82 377 në të gjithë Shqipërinë. Pra, e gjithë Shqipëria ka 82 377 nëpunës që nga Presidenti i Republikës dhe deri në fund.

Kur miratojmë nenin 12, po jua them juve, pasi ministrja e di, do të thotë që kjo është paga më e lartë dhe mbi këtë pagë, pastaj, vazhdon të bëhet piramida e pagës së këtyre 82 mijë vetave të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, bravo, bukur! Çfarë më rezulton mua, zonja Ministre? Ne nisëm të bëjmë një reformë në drejtësi dhe bëmë shumë mirë dhe jemi ndër të parët nga vendet e Europës që po e bëjmë këtë reformë në drejtësi. Nuk është se kemi faj. Ne, si Komision Ligjesh, e kemi miratuar me koshiencë, ju si qeveri që na keni mbështetur, ndërkohë ju, si Ministri e Financave, u keni dhënë atyre paga shumë të larta.

Sot unë kam një tabelë këtu (madje kësaj here do të bëj një gjë shumë interesante që ta bëj sensible, do ta fotokopjoj dhe do t'ua jap të gjithë deputetëve, do t'ia vë në dispozicion edhe Kryetarit të Kuvendit, edhe Kryeministrit që ta kenë përpara, ju po e po e keni, sepse nga ju e kam marrë, nuk kam si të them që ju nuk e keni), e cila, e dini se çfarë thotë, zotërinj kolegë? Thotë: “Pagat në sistemin e drejtësisë” dhe fillon me pagën e kryetarit të Gjykatës së Lartë, që është 326

665; kryetari i Gjykatës së Krimeve të Rënda e ka 326 655... Që të mos i numëroj të gjitha, janë disa funksione deri te Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në Tiranë që e ka 265 725. Pra, mora nga 326 mijë dhe në mënyrë kronologjike i kam ulur deri te 265 mijë. Kjo do të thotë se paga e Presidentit është 257 mijë, pra është përsëri një gjyqtar i Shkallës së Parë Administrative në Tiranë, i Gjykatës së re që kemi krijuar, i cili merr 265 725 lekë, ndërkohë që Presidenti merr 257 mijë.

Kjo fashë, zonja Ministre, përbëhet nga gjyqtarë dhe prokurorë, në fakt, ky është gabimi që e kam kërkuar edhe vitin e kaluar, që ne kemi thënë që do të paguhen, pavarësisht se e kanë kaluar vetingun, që për mua nuk duhet të paguheshin, por duhet të paguheshin ata që e kanë kaluar vetingun, ta meritonin pagën e lartë. Ndërkohë që tani, hopshe, paguhen të gjithë dhe, kur më vjen radha e vetingut mua, e kupton, do të iki nga sistemi i drejtësisë, por lekët nuk i kthej. Pse? Unë jam financier dhe më djeg. Pse të marrë një njeri që do të largohet nga sistemi gjyqësor, për shkak të performancës ose për shkak të pasurisë, dhe mund ta marrë për një ose dy vjet pagën e lartë, ndërkohë që ikën nga vetingu të mos e kthejë atë pagë që ka marrë padrejtësisht? Kjo është pagë e re vlerësuese për ata që e kalojnë vetingun dhe që bëjnë punën si gjyqtarë dhe prokurorë të ndershëm në Shqipëri. Apo nuk është ky thelbi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, e kam shkruar unë kështu në ligj, por mund të nxirrni ju një udhëzim dhe një mundësi për ta rregulluar.

Zotërinj kolegë, sot kemi 790 veta, 472 gjyqtarë dhe 318 prokurorë, që kanë këtë renditje page më të lartë nga Presidenti i Republikës. Shumë mirë, por duhet rregulluar kjo!

Sot, zonja Ministre, kemi institucione, të cilat nuk kanë ndonjë përgjegjshmëri politike, sa keni ju dhe unë, në kuptimin e mirë të fjalës, si ministre apo edhe si deputet. Po e lë Guvernatorin, se, fundja, një kemi me pagën e tij. Po Agjencia e Sigurimit të Depozitave? Merr dyfishin e pagës suaj, për të mos thënë trefishin. Po drejtori i Përgjithshëm i AMF-së? Merr dyfishin e pagës suaj, si ministre, kur nuk ka përgjegjësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po Avokati i Popullit? Merr 3 milionë e 30 mijë lekë, që përsëri nuk e ka përgjegjësinë politike sa e keni ju dhe unë. Po kryetari i KLSH-së, 3 milionë e 30 mijë lekë? Po kryetari i KQZ-së?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kupton? E ka pagën 3 milionë e ca, e të tjera me radhë.

Çfarë dua të them me këtë? Pse i dhashë këta shembuj?

Që të vij në përfundim, i dhashë këta shembuj për të treguar që ka ardhur koha, por ka ardhur ama dhe jo më me llafe.

Ndoshta nuk është në kompetencën tuaj tamam-tamam, dhe unë e kuptoj, se jam administrator i vjetër dhe e njoh qeverinë, është në kompetencën e Departamentit të Administratës Publike për të bërë një detajim.

Ju keni kompetenca financiare më tepër, për të thënë: kemi këto fonde dhe kemi mundësi t'i paguajmë pagat, për të bërë një hierarki të pagave të drejta, të sakta dhe në funksion të reformës në drejtësi që ne kemi bërë me koshiençë të plotë. E kemi bërë me koshiençë të plotë dhe do të thotë që të paktën nenin 12 duhet ta korrigjoni, madje duhet t'i vini qoftë edhe 1 lek më tepër Presidentit të Republikës këtu, se nuk shkon.

Kështu i bie që... Mos na e kaloni pasqyrën tjetër, se nuk e kuptojnë këta, prej 82 mijë e 377 veta. Na e hiqni këtë 700 veta nga ajo.

Ka efekt neni 12, siç e keni vënë ju këtu, për atë tabelë nr. 1, që është 82 mijë e 377 punonjës, minus 798, që marrin më shumë nga Presidenti.

Atëherë, po, ka efekt. Ndërsa me këta 798 veta nuk ka efekt ajo, sepse e kalojmë numrin aq sa duhet dhe, ndërkohë, tabelën e pagave e kalojmë krejt ndryshe. U zgjata paksa nga ana teknike për ta kuptuar kolegët e mi.

Kam edhe diçka të fundit (të cilën e kam merak, sepse janë paratë e shtetit) ka të bëjë me Avokatin e Shtetit. E kam shumë merak këtë Avokatin e Shtetit. E dini pse? Sepse kemi bërë një ligj siç donim ne ta bënim ligjin.

Zoti kryetar, e mbani mend besoj, madje i japim edhe pagë më të lartë nga juaja, zonja Ministre. E dini sa pagë merr Avokati i Shtetit? Merr 95% të pagës së Kryeministrit. Ju nuk merrni aq, por merrni 70% të pagës së Kryeministrit. Pse? Të punojnë 107 veta dhe ka një buxhet, që e pashë këtu, të konsiderueshëm dhe, urdhëro, çfarë thoni këtu në relacionin tuaj të projektbuxhetit tuaj: "Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, që kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve dhe të mosmarrëveshjeve dy a më shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar, përbëjnë gjithashtu një risk real për buxhetin e shtetit". Jam plotësisht dakord, risk real përbëjnë.

Në pjesën më të madhe efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga vetë buxheti i institucioneve (gjëra shumë të vogla, të cilat i di shumë mirë), por

pjesa më e madhe është përballuar nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit. Por nuk e trajtoni dhe as e thoni se sa është përballuar nga ky fond rezervë. Ndaj, unë dua të di dhe dua ta lidh buxhetin e shtetit me performancën e një institucioni, që bën punë ose jo, dhe me fondet që ju, si Ministria e Financave, dhe unë që ngre dorën, i japim një institucioni.

Performanca e mirë e këtyre 107 vetave na bën të mundur që ne të mos paguajmë fatura, siç lexova paragrafin e parë këtu, që rëndojnë te ju, si Ministri e Financave, në qoftë se nuk kanë punuar siç duhet, sa mirë dhe siç duhet, avokatët, ndërkohë ne paguajmë fatura nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit apo nga Gjykata e Strasburgut.

Kjo analizë duhet bërë kur ju bëni projektbuxhetin e institucioneve të caktuara që japin lekë. Madje, jo vetëm ka pagën e lartë, por e kemi vënë në ligj që kur fitohen çështje sensitive shumë të rëndësishme, të marrë edhe shpërblim dhe Ministria e Financave nuk e pengoi dot, por ia jep direkt Kryeministri, sepse ka fituar iks ose ypsilon gjyq.

Ndërkohë, unë di se brenda këtij viti ne kemi humbur gjyqe me 14 milionë euro në Gjykatën e Strasburgut, të cilat i paguajmë kokërr më kokërr, në Vlorën tënde. Këta marrin rrogën, marrin edhe shpërblimin dhe ju i trajtoni me buxhet sikur nuk ka ndodhur asgjë.

Ka ardhur koha të bëjmë një kontroll të imtësishëm të këtyre njerëzve se si punohet dhe se si zbatohet buxheti i shtetit.

Më falni që u zgjata, por, e përsëris, e bëra për teknikë të kuptimit nga kolegët e mi deputetë, sepse këtu shumica janë juristë dhe ju jeni e lumtur në një bisedë me juristët, sepse këta flasin më shumë për ligjet se sa për anën financiare, sepse për anën financiare i kanë rregulluar këto me reformën në drejtësi, ndërsa unë i sqarova më shumë që kolegët e mi t'i sqaroj pse duhen bërë disa pyetje për organet e pushtetit vendor dhe për sistemin e drejtësisë: a jemi ne mirë me këtë projektbuxhet? Unë mendoj se jemi vërtet shumë mirë dhe që duhet ta miratojmë projektbuxhetin. Këto kisha në tërësi.

Faleminderit!

Rezervoj të drejtën për të bërë diskutim politik në parim në fund të mbledhjes.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Duke qenë se relatori, zoti Fino, bëri disa pyetje, ftoj edhe kolegët e tjerë të bëjnë pyetjet e tyre, në mënyrë që ministrja t'i marrë të gjitha pyetjet dhe të japë përgjigje për secilën prej tyre.

Zonja Hysi e ka fjalën për të bërë pyetje!

Zonja Ministre, ju lutem, së bashku me stafin që ju shoqëron, mbani shënim pyetjet, sepse mund të ketë pyetje me natyrë të njëjtë.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin e projektbuxhetit në nivelin makro!

Në vijim të pyetjeve që bëri kolegu Fino, unë kam disa pyetje për disa reforma të ndërmarra dhe për të cilat ne jemi komision përgjegjës për monitorimin e zbatimit të ligjeve.

Pyetja e parë ka të bëjë me reformën në drejtësi të të miturve. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i ka lënë detyrë Ministrisë së Drejtësisë që brenda vitit 2018 duhet të ngrinte qendrën për parandalimin e kriminalitetit të fëmijëve nën moshën e përgjegjësisë penale. Njëkohësisht është e domosdoshme që të gjitha agjencitë që janë pjesë e sistemit të drejtësisë, pra, jo vetëm gjykata, prokuroria, por dhe shërbimet e tjera, duhet të rrisin stafin dhe duhet të krijojnë mjediset për trajtimin e të miturve. Sa është marrë në konsideratë interesi më i lartë i fëmijëve kur është përgatitur projektbuxheti për Ministrinë e Drejtësisë dhe të gjitha institucionet e tjera ligjzbatuese, jo vetëm për sa i përket stafit, por edhe nevojave të tjera që detyron ligji?

Së dyti, në këtë komision është diskutuar gjatë, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, dhe është miratuar në parlament ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Më vjen të keq të them, që, megjithëse ky ligj ka 2 vjet që ka hyrë në fuqi, ka ende problematika për zbatimin e tij. Sa është mbajtur në konsideratë kjo kërkesë për të pasur mundësinë e dhënies së ndihmës parësore dhe dytësore? Një pjesë e buxhetit i shkon Ministrisë së Drejtësisë, por jo vetëm asaj, sepse janë edhe organet e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera që kanë për detyrë të informojnë qytetarët. Sa më i mirë të jetë informimi, aq më e ulët është fatura financiare, që me të drejtë zoti Fino e ngriti: gjyqe të humbura, kohë e humbur, investim shumë i madh në gjykatë dhe sidomos në Gjykatën e Strasburgut.

Çështja e tretë është problemi i ligjit të strehimit social. Kemi thënë që jemi një shtet social dhe e kemi pjesë të programit qeverisës, por sa është mbajtur në konsideratë në fondin që do t'u transferohet organeve të qeverisjes vendore, por edhe në ministrinë që ju drejtoni, pasi ministria juaj është përgjegjëse për të rregulluar politikën në nivel qendror lidhur me strehimin social? Të mos harrojmë se janë 29 kategori që përfitojnë. Në këtë kuadër, zbatimi i këtij ligji është respektim i lirive dhe të drejtave të shumë kategorive, të cilët përbëjnë shumicën e popullsisë. Këtë pyetje po e bëj edhe në emër të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut.

Pyetja e katërt ka të bëjë me minoritetet dhe ligjin “Për minoritetet”. Ne kemi ristrukturuar Këshillin Kombëtar të Minoriteteve. Një element shumë i rëndësishëm dhe një premtim që kemi bërë është mbështetja e këtij këshilli për të promovuar jo vetëm një shoqëri gjithëpërfshirëse, por vlerat dhe kulturat. Në kuadër të pozicionit që ka Shqipëria në rajon, por edhe të rëndësisë që ka promovimi i bashkëpunimit rajonal ku minoritetet janë ura lidhëse, sa është mbajtur në konsideratë ky element? Unë e kuptoj që ulja e borxhit është shumë e rëndësishme (e kishit bërë me bold në projektbuxhet), por nuk është vetëm ulja e borxhit e rëndësishme. Borxhet që kanë krijuar të gjitha qeveritë dhe të gjithë të tjerët që nuk i kanë menaxhuar si duhet nuk duhet të jenë në kurriz të promovimit dhe mbrojtjes së drejtave të njeriut. Pra, duhet të ketë një balancë shumë më të mirë midis uljes së borxhit, që ju e keni fokusin kryesor, dhe mbrojtjes së shumë kategorive që unë ju përmenda dhe që nuk janë pak.

Së fundi, megjithëse besoj që zoti Fino do ta ketë në vëmendje te Nënkomisioni për Organet e Qeverisjes Vendore, ne kemi detyrime që në nivel vendor të krijojmë mekanizma për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve. Mua më vjen keq të them që sot, nga 61 bashki që ka në Shqipëri, gati 30 ose 40% e tyre nuk i kanë ngritur ose i kanë ngritur mekanizmat e referimit të rasteve të dhunës në familje ose mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve, por nuk janë eficientë: ose nuk buxhetin, ose nuk kanë infrastrukturën e nevojshme, ose kanë vështirësi të tjera për shkak të borxheve dhe problematikave që mund të kenë dhe janë fokusuar vetëm në pagimin e pagave e punonjësve. Por nuk është çështja të mbajmë vetëm një administratë në organet e qeverisjes vendore. Në këtë kuadër, a janë pasur në konsideratë detyrimet që kemi për këto dy kategori, gratë dhe fëmijët?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuar zonja Ministre!

Në fakt, jo se unë jam ekspert në ekonomi dhe financë, por për shkak të kontakteve që kemi me njerëz të ndryshëm (familjet tona përbëhen nga probleme që sjellin njerëzit), do doja të dija a kompensohen ish-pronarët me një fond prej 4,5 miliardë lekësh. Për shkak të problematikave që paraqesin ata, a e mbulon ky fond kompensimin e tyre, sepse njohim raste që ish-pronarët presin zgjidhje nga viti në vit? Pra, a e zgjidh ky fond këtë problem?

Së dyti, sa ka qenë numri i punonjësve të administratës kur kishim rreth 390 komuna dhe bashki dhe sa është aktualisht në 61 bashkitë e vendit? Pra, a ka diferencë?

Në nenin 11, paragrafi i dytë, ju thoni që numri rezervë i parashikuar në tabelën nr. 2 përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. A mund të kemi një numër të përcaktuar përafërsisht sa ka qenë në këtë vit, jashtë numrit total rreth 82 mijë. Pra, sa ka qenë numri i vendeve të punës?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Po, zonja Braha.

Ediola Braha – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja Ministre, a është parashikuar buxheti i nevojshëm për zbatimin e reformës penitenciare, që është propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe a është aktualisht në fazën e shqyrtimit të paketës ligjore në Kuvendin e Shqipërisë?

Disa institucione të drejtësisë si Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë kanë kohë që nuk funksionojnë. Nga pikëpamja buxhetore ato kanë kursyer para. Këto para të kursyera, nëse po, janë rialokuar diku apo është menduar të përdoren në vitin e ardhshëm për këto organe?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Braha!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Nuk ka.

Zonja Ministre, ju lutem, përgjigjuni sipas radhës së pyetjeve që kanë bërë kolegët.

Anila Denaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, do të jap disa përgjigje. Ndërkohë, kërkoj ndihmën edhe të kolegëve të mi, respektivisht për buxhetin, zonjës Dhëmbi dhe për pushtetin vendor zotit Fran.

Në raport me faturën financiare të reformës në drejtësi, më lejoni të theksoj sa është kjo faturë për vitin korrent dhe pastaj për shtesat në vitin 2020.

Fonde shtesë për sistemin e drejtësisë në vitin 2019 janë 2,6 miliardë lekë. Konkretisht: paga të reja 1 miliard lekë, shpenzime për krijimin e institucioneve veting, KLP, KLGJ 700 milionë lekë, investime të dhëna ministrive 650 milionë, institucioneve të drejtësisë, shtesa për prokurorinë dhe magjistraturën 250 milionë.

Këto i takojnë vitin 2019, pra, 2,6 miliardë lekë. Për vitin 2020 parashikohet një shtesë prej 1,1 miliardë lekësh, pa futur 300 milionë lekë që janë pjesë e fondit rezervë, i cili është i akorduar: nga 1,7 miliard, 300 milionë lekë janë për institucionet e drejtësisë. Sigurisht, konteksti

financiar buxhetor mbështetet në të gjitha ligjet e aprovuara dhe shkon në përputhshmëri të plotë me të gjitha strukturat e pagave të aprovuara.

Kërkesa që bëri zoti Fino në raport me kategorizimin dhe analizën hierarkike të pagave m'u bë edhe dje nga zoti Ahmetaj në Komisionin e Ekonomisë. Besoj që rruga juridike për të adresuar këtë çështje mund të përdoret nga të gjitha institucionet, nga komisioni, nga ministria, sepse kjo është një përgjegjësi e përbashkët. Ministria e financave ka obligimin që çdo ligj të aprovuar në parlamentin e Shqipërisë dhe çdo strukturë page ta aplikojë në fonde buxhetore. Konfirmoj që reforma në drejtësi është e mbështetur plotësisht, si për vitin 2020, ashtu edhe për vitin 2019. Për sa i përket pjesës së rishikimit, ne mund ta diskutojmë rishikimin e strukturave në një kuadër më të gjerë, por nuk besoj që është sot momenti për të vendosur se si do të shkojmë përtej.

Për sa i takon pushtetit vendor, më lejon të theksoj që në gjykimin tim pushteti vendor ka tri elemente të rëndësishme për këtë vit.

Së pari, ka fondet buxhetore. Jam plotësisht dakord me zotin Fino kur thotë që potenciali për t'u mbështetur me më shumë fonde buxhetore nga vetë ligjet që janë të aprovuar ekziston dhe nuk është shfrytëzuar. Konkretisht, taksa e pronës nuk është e shfrytëzuar 100%. Mund të theksoj që kadastra fiskale, që është një projekt që menaxhohet nga Ministria e Financa dhe Ekonomisë, është një projekt që aktualisht funksionon, por janë ende 33 bashki, të cilat ende nuk kanë marrë vendime në këshillat bashkiak të tyre për të ekzekutuar vendime që lidhen me taksën e pronës. Kjo shkon përtej kontekstit të të dhënave. Në parim duhet që pushteti vendor të marrë përsipër se si të adresojë taksën e pronësisë në vijim, jo vetëm për vitin 2020. Ndërkohë për transfertën e kushtëzuar ne i kemi informacionet e ardhura edhe nga institucionet e njëjta buxhetore në rajon. Konkretisht, informacioni për Ministrinë e Financave është në nivelin e 3,2% dhe do të vazhdojë të rritet në të ardhmen. Më lejon të theksoj se Mali i Zi e ka më të lartë, e ka 4,9%, Maqedonia 4,6% Serbia 5,6% dhe kjo është referenca që i bën zoti Fino diferencës që ekziston me Shqipërinë. Megjithatë, nga viti 2013, që ishte 2,5%, sot e kemi 3,2% dhe treguesi në rritje vlen për t'u përmendur dhe për t'u theksuar. Nëse kjo përqindje do të rritet, unë propozoj që ne të shikojmë jo këtë si një zgjidhje të parë, por të shikojmë të gjitha mundësitë që sot i kanë bashkitë si një zgjidhje prioritare, siç e përmenda kadastrën fiskale, dhe pastaj të shikojmë në rritje edhe përqindjen e kushtëzuar, nëse ky element i parë i të ardhurave është ezauruar në pushtetin vendor.

E rëndësishme për pushtetin vendor nuk është vetëm gjenerimi i të ardhurave, por edhe menaxhimi i shpenzimeve, sidomos në raport me krijimin e detyrimeve të prapambetura. Më lejoni të theksoj se në raport me detyrimet e prapambetura, në vitin 2016 detyrimet e prapambetura të bashkive kanë qenë nivelin 11,8 miliardë lekë. Në këtë vit, në vitin 2016, filloi të zbatohet nga pikëpamja buxhetore reforma administrativo-territoriale. Stoku i mbetur aktualisht është 6,6 miliardë lekë. Pra, tendenca nga viti 2016 në vitin korrent ka ardhur në rënie dhe, sigurisht, kjo është falë presionit që bëhet në nivelin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së pari, duhet të kuptojmë pse u krijuan detyrimet e prapambetura. Zgjidhja me amnistinë mund të vijë pasi të kemi kuptuar se çfarë shkoi gabim. Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme të dimë, në radhë të parë, sesi pushteti vendor menaxhon shpenzimet për projektet e tyre dhe si e trajton detyrimin e prapambetur përpara se të fillojë të bëjë investime të reja.

Bashkim Fino- Meqenëse para 3 vjetësh bëmë reformën territoriale dhe këtu flitet për kohën kur ishin 380 njësi vendore, me ndarjen e re territoriale, ndoshta Ministria e Financave dhe ne duhet të kishim bërë një hap e t'u kishim thënë bashkive të reja se kanë këtë mundësi që ta zgjedhin. Pra, ka bashki që janë në ulje, por ka edhe bashki që nuk e zgjidhin dot. Kjo është logjika dhe jo të bëjmë amnisti fiskale sa herë që bashkitë nuk performojnë mirë dhe nuk i trajtojnë mirë problemet.

Anila Denaj – Unë e kuptoj dhe nuk e kundërshtoj argumentin tuaj, megjithatë, i gjithë procesi i analizës, edhe në zbatim të ligjit të financave vendore, është të nxjerrë një udhëzim që po bën një analizë për të gjitha vështirësitë financiare të të gjitha bashkive dhe qarqet në bazë të një vetëvlerësimit të situatës financiare. Kjo analizë, e cila është duke u përgatitur me të dhënat, sigurisht që do të disponojë informacion të mjaftueshëm nëse është çështje e të ardhurave të limituara, e shpenzimeve të tepërta, ndoshta të pakontrolluar, apo është çështje e një reforme tranzitore, ose kalimi nga një reformë në një tjetër, që sigurisht mund të çojë në propozime, si ajo që përmendet ju, zoti Fino. Këtë duhet ta shohim pas një analize, e cila ka nisur sot dhe është në bazë të një vetëvlerësimi, por sigurisht që Ministria e Financave do të jetë.

Së treti, në pushtetin vendor një **pilar** i fundit, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten në të ardhmen probleme të tilla, është ...

Ulsi Manja- Ju lutem, mbani qetësi, në mënyrë që ministrja të mbarojë me përgjigjet e pyetjeve.

Anila Denaj – është çështja e formatit audit. Bashkitë kanë raportet e tyre të auditit në çdo njësi të tyre, megjithatë, mendojmë se kemi ende punë për të bërë në raport me komitetet e auditit për të diskutuar këto problematika vit pas viti në qarqe dhe jo vetëm në nivelin e Ministrisë së Financave, pasi qarku është një nivel hierarkik jo pak i rëndësishëm për të adresuar si të ardhurat, ashtu edhe shpenzimet dhe miradministrimin e tyre. Së bashku me zotin Lleshaj jemi duke e diskutuar se si kjo strukturë të funksionojë, në mënyrë që komitetet e auditit të jenë funksionale dhe efektive për të bërë këtë analizë, jo vetëm sot për arsye të reformës së ndryshuar, por edhe në vijueshmëri për një menaxhim efektiv.

Në raport me pyetjet e zonjës Hysi, më lejoni t'ju them që çështja e trajtimit të të miturve është një çështje që ne e kemi trajtuar edhe drejtpërdrejt së bashku me ministren e Drejtësisë. Dy ishin elementet të konteksti, për të cilin ne jemi në gjysmë të rrugës.

Së pari, numri i personelit, të cilin e debatuar në kontekstin e tij të plotë, nga 70 ne aprovuam 35, ku mendojmë se një numër i tillë është i mjaftueshëm për fillimin e funksionimit, sikurse kemi parë të gjitha mundësitë që godinat, të cilat janë në administrim apo në pronësi të qeverisë shqiptare, të kenë mundësi të jepen përpara se të jetë e nevojshme për të ndërtuar diçka nga fillimi. Sigurisht, këto kërkesa janë specifike, sepse nuk duhet të jetë në qendra të banuara, duhet të jetë e veçuar, por së bashku me ministren e Drejtësisë jemi duke parë elementin e godinës për ta mundësuar atë. Në qoftë se numri për fazën e parë do të ishte i mjaftueshëm, ne do të ishim të gatshëm që ta aprovonim atë.

Së dyti, lidhur me çështjen e politikave të strehimit, më lejoni t'ia kaloj fjalën zonjës Dhëmbi, personi që e menaxhon prej vitesh këtë sektor.

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Denaj!

Zonja Dhëmbi, ju lutem sa më shkurt përgjigjet e pyetjeve të kolegëve, sepse duke qenë se jemi në shqyrtimin dhe miratimin në parim, kolegët mund të kenë diskutime.

Mimoza Dhëmbi- Strehimi mbulohet nga Ministria e Financave, pikërisht nga Drejtoria e Buxhetit. Siç jeni në dijeni, një ligj i ri është bërë vitin e kaluar dhe këtë vit jemi të përfshirë në procesin e nxjerrjes së akteve nënligjore, i cili është një proces shumë intensiv, sepse mund të jenë rreth 30 akte nënligjore për ta vënë në funksionim të plotë ligjin. Janë bërë gjysma e tyre, ku një pjesë është miratuar nga qeveria, ndërsa pjesa tjetër është në proces. Kjo ishte nga pikëpamja ligjore. Nga pikëpamja e fondeve, në buxhetin e vitit 2020 janë parashikuar 309 milionë lekë për subvencionimin e politikave të interesave dhe të bonusit të qirasë dhe 320 milionë lekë për

investime. Dua të theksoj se në totalin e fondit që lidhet me mbështetjen e interesave të kredive për familjet e pastreha, ne mund të akomodojmë një numër gjithmonë e më të lartë. Unë nuk mund ta them tani fiks se sa është numri i familjeve të reja që do të përfshihen këtu, por fakti që interesat në tregun e kredive janë shumë të ulëta dhe ne kemi bërë një marrëveshje të re me sistemin bankar, ku interesat janë mjaft të ulëta dhe kostoja e buxhetit është shumë e ulët, ne mund të akomodojmë shumë më tepër familje. Jemi ne ata që e shpërndajmë numrin e të pastrehëve për çdo bashki dhe këtë fond e administrojnë bashkitë. Investimet mbështesin shtresat vulnerabël dhe ju e dini që ne mbështesim rikonstrukcione godinash, ish-ndërmarrje të vjetra, të cilat i adoptojmë në banesa sociale dhe i financojmë kundrejt projekteve. Kjo është një ndihmë maksimale që u jepet shtresave vulnerabël, veçanërisht këtyre më të dobëta, si: romët, egjiptianët e të tjera, duke plotësuar edhe disa kushte që kemi në marrëveshje të tjera të integritit.

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Besoj se kolegët i morën përgjigjet.

Anila Denaj- Lidhur me pyetjet për ish-pronarët, pyetja që u shtrua në kontekst financiar është e argumentuar në fjalimin tim. Ne kemi një detyrim ligjor për t'i paguar ato në 10 vjet, 50 miliardë lekë, megjithatë kjo vlerë vjen duke u rritur nga njëri vit në tjetrin.

Për sa i takon pushtetit vendor, një element të fundit në raport me personelin edhe për ta përmbyllur çështjen e kategorizimit, dua t'ju them që te numri 82 nuk është personeli i pushtetit vendor, sepse pushteti vendor ka një kategorizim, sikurse e thamë edhe më parë, për t'u vlerësuar. Unë nuk e kam aktualisht numrin konkret, por do t'ju japim, ose do t'u japim me email të gjitha kategoritë e detajuara.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Nuk ka pyetje të tjera nga kolegët.

Në fakt, ne do të kemi gjatë gjithë javës dëgjesa me 22 institucione për buxhetin e vitit 2020. Sigurisht, në diskutimin e projektbuxhetit do të kemi prezentë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe, lidhur me pyetjet që kanë interes për sistemin e drejtësisë, pushtetin vendor dhe për administratën publike, besoj do të shtjellohen më në detaje, do të reflektohen dhe adresohen për komisionin përgjegjës edhe nevojat që këto institucione mund të kenë për buxhet në vitin 2020. Kështu që, unë pa humbur kohë, ftoj kolegët në diskutim për projektbuxhetin para se ta votojmë në parim.

A ka diskutime nga kolegët?

Po, zoti Braho.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zoti Braho!

Zoti Fino, përpara se t'jua kaloj fjalën si relator i projektbuxhetit, a ka diskutime të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë, zoti Fino, një konsideratë për projektbuxhetin e paraqitur dhe pastaj të kalojmë në votim.

Bashkim Fino- Faleminderit, zoti kryetar!

Projektbuxheti çdo vit që kalon është si puna e dasmës, që i fton njerëzit dhe mund të kesh harruar ndonjë, ngelet i pakënaqur, por dasma bëhet dhe del me sukses. Çfarë dua të them me këtë?! Dua të them se asnjë buxhet nuk mund të quhet i arrirë në çdo fushë, por, kur shikon që në fusha të caktuara ti ke rritje të të ardhurave dhe u jep mundësinë që të performojnë më mirë vitin tjetër, duhet të jesh i kënaqur që këto shifra janë kështu siç janë dhe duhet t'i realizosh. Domethënë, buxheti i vitit 2020, që diskutojmë sot, është një buxhet, për mua, i stabilizuar, i vazhdimësisë, i qëndrueshmërisë dhe i rritjes ekonomike. 4% rritje ekonomike, siç e ka thënë në relacion ministrja, është një gjë shumë e mirë dhe, po ta shikosh, është pothuajse njësoj me vendet e rajonit.

Së pari, ky është një projektbuxhet që ul deficitin buxhetor. Nuk duhet të harrojmë se ulja e deficitit buxhetor tregon kur ke një buxhet të fuqishëm dhe do të vazhdojë të ulet deri në vitin 2022 nën 60 %. Mua, si ekonomist që jam, ulja e deficitit më bën optimist.

Së dyti, projektbuxheti mbështet një ndër reformat më të rëndësishme, kjo është krenaria jonë si Komision i Ligjeve, për qytetarët e vendit, atë të drejtësisë. Më lejoni t'ju them se buxheti i të gjitha organeve të institucioneve të drejtësisë është rritur në masën 6 % më shumë se buxheti i vitit të kaluar. Pra, vjet ata kanë kërkuar, nëse e mbani mend ju disa herë kemi bërë debate dhe diskutime, për shtesë numri punonjësish dhe pagash dhe ua kemi dhënë. Ndërsa buxheti i vitit 2020 është 6% më i madh se ai i vitit 2019. Domethënë, për herë të parë, po të shikoni relacionin, unë e kam lexuar me kujdes, sepse më pëlqen, dhe kam parë pasqyrat, në buxhetin e vitit 2020 fillon funksionimin SPAK-ut dhe Byroja e Hetimit. Aty janë planifikuar 165 punonjës, është planifikuar buxheti që do të trajtohet me 512 milionë lekë dhe kështu që buxhetin e vitit 2020, me plot zë, jua rekomandoj edhe të gjithë anëtarëve të Komisionit të Ligjeve, ta quajmë buxhetin e zbatimit të reformës në drejtësi, aq të mirëpritur nga opinioni i brendshëm dhe miqve tanë

ndërkombëtarë. Kjo është fjalia më kuptimplote që ne duhet ta themi me forcë e me zë të lartë edhe kur të bëjmë dëgjesat me ta.

Së treti, buxheti i vitit 2020 përkon me mandatin të të zgjedhurve vendorë pas reformës territoriale-administrative, si dhe me vitin e dytë të miratimit të ligjit të financave të qeverisjes vendore, të cilat kanë ecur paralelisht. Pyetjet që unë bëra, i bëra në mënyrë që në buxhetin e vitit 2021 ne të kemi më në konsideratë të rritim mundësinë se sa mirë do të performojnë ato për të rritur nga taksat vendore, nga taksa e pronës, nga kadastra dhe pastaj, siç e thatë edhe ju, nga granti i pakushtëzuar.

Zonja Ministre, ne gjithmonë kërkojmë dhe do të kërkojmë që 1%-shi të jetë më i lartë. Unë e di që është 3,2 % i GDP-së i gjithë të ardhurave të pushtetit jovendor, por mora në analizë dhe thashë që vetëm granti i pakushtëzuar që ti u jep organeve të pushtetit vendor është 1%. Këtë e thotë ligji i financave vendore. Ajo që kërkojmë ne është që të kemi akoma më shumë. E drejta jonë është të kërkojmë, ashtu siç është e drejta juaj që të toleroni dhe të na jepni diçka.

Së katërti, ky projektbuxhet mbështet në mënyrë të veçantë, e tha ministrja, por nuk e thamë ne të tjerët, do ta them me forcë edhe kur të diskutohet, një reformë të jashtëzakonshme të arsimit parashkollor. A e dini se në këtë projektbuxhet sot ne kemi parashikuar që për fëmijët e moshës 3-6 vjeç do të kemi më shumë se 300 edukatore në të gjitha bashkitë? Kjo është një reformë e re që është bërë. A e dini që fondi që do të jepet për ta është 327 milionë lekë për vitin 2020 për bashkitë? Pra, sot do të ketë një edukatore me 15-20 fëmijë, nuk do të ketë më shumë. Reforma është bërë mbi numrin e fëmijëve 3-6 vjeç dhe nuk është bërë mbi numrin e edukatoreve. Kjo do të thotë që reforma në arsimin parashkollor është një reformë e jashtëzakonshme dhe e shoqëruar me fonde. Në momentin që kjo reformë është shoqëruar me 327 milionë lekë, do të thotë që kështu duhen shoqëruar të gjitha reformat që bëjmë për organet e pushtetit vendor.

Së fundi, për mendimin tim si ekonomist, projektbuxheti hedh themelet e një konsolidimi të treguesve makroekonomikë dhe fiskalë, duke siguruar punësimin, sipërmarrjen, pensionistin, nxënësin, studentin e të tjerë që të ketë një klimë më të mirë, më të stabilizuar dhe më të zhvilluar. Pra, në të gjitha këto aspekte dhe në ato që thatë ju, të cilat ne do t'i shikojmë hap pas hapi me të gjitha institucionet për të bërë një rregullim teknik të mundshëm, në qoftë se mund të bëjmë, unë mendoj se ky projektbuxhet duhet të miratohet nga të gjithë.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Fino!

Unë bashkohem me të gjitha konsideratat dhe konstatimet që relatori, zoti Fino, tha për projektbuxhetin e vitit 2020. Ky projektbuxhet ul deficitin buxhetor dhe me të drejtë zoti Fino propozon ta quajmë buxheti i zbatimit të plotë të reformës në drejtësi. Unë nuk jam ekspert si zoti Fino, por, nëse nuk gabohem, janë 2,6 miliardë që i takojnë vitit 2019, ku nga ky buxhet 2,6 miliardë për reformën në drejtësi apo për sistemin e drejtësisë aktualisht në gjendje në fondin rezervë janë 300 milionë dhe në projektin e vitit 2020 shtohet me 1,1 miliardë ose e përkthyer në përqindje, siç tha kolegu Fino, buxheti i vitit 2020 për sistemin e drejtësisë dhe për zbatimin e plotë të reformës në drejtësi rritet me 6%. Besoj se ky buxhet e meriton të quhet buxheti i drejtësisë.

Më vjen mirë që prezent kemi ministren dhe stafin që e shoqëron dhe shfrytëzoj rastin që të gjithë kolegët e Komisionit të Ligjeve, por edhe të komisioneve të tjera të Kuvendit që ashtu si kolegu im Fino, i cili evidenton arritjet e këtij buxheti, duhet t'i shpjegohen edhe opinionit publik. Kjo është shumë e rëndësishme. Në këtë projektbuxhet është vënë theksi tek arsimi parashkollor, ose arsimi në përgjithësi. Arsimi dhe drejtësia janë dy shtyllat e zhvillimit të një kombi. Mua më vjen mirë që është rritur buxheti për arsimin parashkollor me 327 milionë, nëse nuk gabohem, dhe në vitin 2020 do të kemi 300 edukatore më shumë për brezin e arsimit parashkollor.

Zonja Ministre, ju falënderoj ju dhe kolegun Fino, të cilin e kemi për nder që e kemi anëtar të Komisionit të Ligjeve dhe ekspert të buxhetit, madje unë mendoj që zoti Fino të jetë relator i projektbuxhetit edhe në 8 komisionet e përhershme të Kuvendit, për prezantimin e projektbuxhetit.

Kalojmë në votimin në parim. Kush është dakord në parim me projektbuxhetin e vitit 2020? 1 kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet në parim projektligji “Për buxhetin e vitit 2020”.

Me miratimin në parim e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Shumë faleminderit kolegëve, ministres, stafit që e shoqëron atë dhe medieve!

Javës tjetër do të fillojmë dëgjesat për projektbuxhetin.

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA